

AKT THEMELIMI

“ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE” SH.A

Shoqëria “ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE” Sh.A është themeluar ne përputhje me legjislacionin shqiptar te shoqërive tregtare, Statutin dhe kete Akt Themelimi sipas aksionareve te meposhtem:

1. Shoqëria me emrin «KALLIERGIES YDROVION ORGANISMON ANONIMOS ETAIRIA» dhe emrin dallues «ANDROMEDA A.E», nje shoqëri anonime e organizuar dhe e themeluar sipas ligjeve greke me Vendimin Nr. 5884 date 23.11.1998, me seli ne Rios, Patra, Greqi e perfaqesuar nga Z. Panagiotis Boutopoulos, shtetas grek, banues ne Greqi, mbajtes i Pasaportes Nr. AB 4810425 e leshuar me 4.1.2007 nga A.E.A/A.A.-N.P.C., me zotesi te plote juridike per te vepruar,
2. Z. Ahilca Papuci, shtetas shqiptar, lindur ne Sarande, Shqiperi, ne 25.01.1947, banues ne ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i Pasaportes Nr. Z0544693, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Neni 1 – Forma ligjore

- 1.1 Shoqëria është themeluar ne formen e shoqërise anonime ne përputhje me ligjin tregtar shqiptar.

Neni 2 – Forma ligjore

Shoqëria do të ketë formën e një Shoqërie Anonime në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 3 – Selia.

- 3.1 Selia e shoqërisë është në Rruga Skenderbeu, Nr. 25, Sarande, Shqiperi.

Neni 4 – Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është 50 vjet duke filluar nga data e themelimit të Shoqërisë si person juridik në Regjistrin Tregtar.
- 4.2 Shoqëria mund të prishet në cdo kohë ose afati i saj 50 vjecar mund të zgjatet me Vendim të Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

 1

Neni 5 – Objekti i Veprimtarise

- 5.1 Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:
- a. Prodhimi i peshqve te vegjel dhe kultivimi i organizmave ujore ne ujera te kripura dhe te cmbla si dhe tregtimi, perpunimi dhe paketimi i tyre;
 - b. Prodhimi dhe tregtia e pajisjeve per kultivimin e peshkut;
 - c. Prodhimi dhe tregtimi i ushqimit per peshk;
 - d. Krijimi dhe operimi i nje qendre kerkimore ne lidhje me proshimin dhe shperndarjen e e organizmave ujore.
 - e. Krijimi i vendeve te argetimit ne fushen e akuakultures dhe turizimit te peshkimit;
 - f. import– eksporti i produkteve te siperpermendura dhe prezantimi i biznesit te brendshem dhe te jashtem qe ndjek te njejtat objektiva me ato te shoqerise.
- 5.2 Objekti i veprimtarise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.3 Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse, të cilat mbështesin arrijten e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 6 – Kapitali Aksionar. Aksionet

- 6.1 Kapitali Aksionar është shlyer tërësisht me të holla në dorë në shumën 2.000.000. Lekë (dy milionë).
- 6.2 Kapitali Aksionar është i ndarë në 20.000 (njëzet mijë) aksione të pandashme me vlerë nominale 100 lekë (një qind) secili.
- 6.3 Aksionarët kanë nënshkruar dhe shlyer tërësisht aksionet si vijon:
1. “Andromeda” A.E. ka 1,502 (nje mije e peseqind e dy) aksione ose 75,1% te kapitalit te shoqerise.
 2. “Arqilea Papuci” ka 498 (katerqind e nentedhete e tete) aksione ose 24,9% te kapitalit te shoqerise.

Neni 7 – Organet kompetente

- 7.1 Organet kompetente te Shoqerise jane:
- Asambleja e Pergjithshme qe eshte organi me i larte drejtues i Shoqerise.
 - Keshilli Mbikeqyres qe eshte autoriteti qe mbikeqyr administrimin e shoqerise. Ai perbehet nga tre anetare te emeruar nga Asambleja e Pergjithshme. Keshilli i pare Mbikeqyres perbehet nga si me poshte:



1. Z. Panagiotis Kolios (Kryetar)
2. Z. Apostolos Touralias (anetar)
3. Z. Aleks Naco (anetar)

Bordi i Drejtoreve i ngarkuar me administrimin e perditshem te shoqerise Brenda objektit te shoqerise. Bordi i Drejtoreve eshte i perbere nga tre anetare. Mr. Panagiotis Boutopoulos, b) Mr. Achilea Papuci and c) Mr. Konstantinos Glavas (anetar jo ekzekutiv).

- Drejtori i pare i Pergjithshem eshte Z. Panagiotis Boutopoulos.

Neni 8 – Viti financiar

- 8.1 Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga 1 Janari dhe mbaron më 31 Dhjetor me përjashtim të vitit të parë financiar i cili fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor 2006.

Neni 9 - Dividendët

- 9.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe pasi është vendosur shuma që do të ndahet, Asambleja e Aksionarëve përcakton shumën që do tu shpërndahet Aksionarëve si dividend sipas neneve 215, 216 të Ligjit të Shoqerive tregtare.

Neni 10 – Dispozita të përgjithshme

- 10.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 5 kopje në Shqip dhe Anglisht me vlerë të njejtë ligjore dhe pasi ju lexua Aksionarëve në prani të perkthyeses së gjuhës angleze Sofika Rapi u nënshkrua rregullisht prej tyre.

AKSIONARET E “ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE” Sh.A.

Ne emer dhe per llogari te ANDROMEDA S.A.

ΚΑΛΑΙΕΡΙΟΥ 711 - ΥΠΟΒΡΙΝΟ ΠΕΤΕΛΙΜΩΝ
ΑΝΔΡΟΥΣΙΟΥ ΕΛΛΑΔΑ

ΠΑΡΑΡΤΗΡΙΑ ΚΑΙ Ο ΚΑΤΑΡΤΙΣΤΗΣ ΠΡΟΫ ΑΝΑΛΕ Τ.Κ. 265:

Mr. Panagiotis Boutopoulos

A.T.M. 094346336 - A.S.O.Y. ΠΑΤΡΩΝ

A.M.A.F. 51614/275/08/03

Panagiotis Boutopoulos

Z. Achilea Papuci

Achilea Papuci

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. REP. 7872
NR. KOL.

1168

Tiranë, më 8./05/2007

VËRTETIM


Sot, më datë 8./05/ 2007, para meje Ariana Mallkuci, notere e Dhomes së Notereve Tiranë, u paraqiten personalisht personat e mëposhtem:

1. Shoqëria me emrin «KALLIHERGIES YDROVION ORGANISMON ANONIMOS ETAIRIA» dhe emrin dallues «ANDROMEDA A.Ë», një shoqëri anonime e organizuar dhe e themeluar sipas ligjeve greke me Vendimin Nr. 5884 date 23.11.1998, me seli në Rios, Patra, Greqi e perfaqesuar nga Z. Panagiotis Boutopoulos, shtetas grek, banues në Greqi, mbajtës i Pasaportes Nr. AB 4810425 e lëshuar më 4.1.2007 nga A.E.A/A.Ë.-N.P.C., me zotësi të plote juridike për të vepruar,
2. Z. Ahilea Papuci, shtetas shqiptar, lindur në Sarandë, Shqipëri, në 25.01.1947, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportes Nr. Z0544693, me zotësi të plote juridike për të vepruar;

te cilet nënshkruan rregullisht para meje në prani të përkthyeses së gjuhës angleze Sofika Rapi, Akt Themelimit si më sipër dhe unë noteri vërtetoj firmën e tyre sipas ligjit.

NOTERE

ARIANA MALLKUCI



Perktheu: Sofika Rapi
[Signature]



STATUT I SHOQERISE ANONIME
"ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE" SH.A

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to be the name "J. M. M."

A smaller handwritten signature in black ink, appearing to be the name "H. M. M."

Neni 1- Aksionaret themelues

Shoqëria anonime me emrin "ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE SH.A." krijohet në përputhje me Ligjin Shqiptar për Shoqëritë Tregtare, Aktin e Themelimit, dhe këtë Statut nga Aksionarët e mëposhtëm:

1. Shoqëria me emrin «KALLIERGIES YDROVION ORGANISMON ANONIMOS ETAIRIA» dhe emrin dallues «ANDROMEDA A.E», nje shoqëri anonime e organizuar dhe e themeluar sipas ligjeve greke me Vendimin Nr. 5884 date 23.11.1998, me seli ne Rios, Patra, Greqi e perfaqesuar nga Z. Panagiotis Boutopoulos, shtetas grek, banues ne Greqi, mbajtes i Pasaportes Nr. AB 4810425 e leshuar me 4.1.2007 nga A.E.A/A.A.-N.P.C., me zotesi te plote juridike per te vepruar,
2. Z. Ahilea Papuci, shtetas shqiptar, lindur ne Sarande, Shqiperi, ne 25.01.1947, banues ne ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i Pasaportes Nr. Z0544693, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

KAPITULLI I

THEMELIMI - FORMA- SELIA EMRI - KOHËZGJATJA- OBJEKTI

Neni 2 – Forma ligjore


Shoqëria do të ketë formën e një Shoqërie Anonime në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 3 – Selia.

- 3.1 Selia e shoqërisë është në Rruga Skenderbeu, Nr. 25, Sarande, Shqiperi.
- 3.2 Shoqëria mund te hape dege, agjensi, filiale ose sherbime ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise me Vendim Asambleje.

Neni 4 - Emri

4.1 Emri i Shoqërisë do të jetë "ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE SH.A" dhe emri i shkurtuar do te jete "ANDROMEDA MARINE".



Neni 5 - Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është 50 vjet duke filluar nga data e themelimit të Shoqërisë si person juridik në Regjistrin Tregtar.
- 5.2 Shoqëria mund të priset në cdo kohë ose afati i saj 50 vjecar mund të zgjatet me Vendim të Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 6 – Objekti i Veprimtarisë

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
- Prodhimi i peshqve të vegjël dhe kultivimi i organizmave ujore në ujera të kripura dhe të embla si dhe tregtimi, përpunimi dhe paketimi i tyre;
 - Prodhimi dhe tregtia e pajisjeve për kultivimin e peshkut;
 - Prodhimi dhe tregtimi i ushqimit për peshk;
 - Krijimi dhe operimi i një qendre kërkimore në lidhje me proshimin dhe shpërndarjen e organizmave ujore.
 - Krijimi i vendeve të arzetimit në fushën e akuakultures dhe turizimit të peshkimit;
 - import– eksporti i produkteve të siperpërmendura dhe prezantimi i biznesit të brendshëm dhe të jashtëm që ndjek të njëjtat objektiva me ato të shoqërisë.
- 6.2 Objekti i veprimtarisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse, të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI II

Kapitali Aksionar – Aksionet

Neni 7 - Kapitali Aksionar. Aksionet

- 7.1 Kapitali Aksionar është shlyer tërësisht me të holla në dorë në shumën 2.000.000. Lekë (dy milionë).
- 7.2 Kapitali Aksionar është i ndarë në 20.000 (njëzet mijë) aksione të pandashme me vlerë nominale 100 lekë (një qind) secili.
- 7.3 Aksionarët kanë nënshkruar dhe shlyer tërësisht aksionet si vijon:
- "Andromeda" A.F ka 1,502 (një mijë e pesëqind e dy) aksione ose 75,1% të kapitalit të shoqërisë.
 - "Ahilea Papuci" ka 498 (katërqind e nentëdhjetë e tete) aksione ose 24,9% të kapitalit të shoqërisë.



Neni 8 - Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1 Zmadhimi i kapitalit bëhet me Vendim të Asamblesë së Aksionarëve duke u bazuar në një raport të bërë nga Drejtori i Përgjithshëm. Statuti do të ndryshohet në përputhje me këtë Vendim.
- 8.2 Aksionarët kanë të drejtën e preferimit në lidhje me nënshkrimin aksioneve të pagueshme në para të cënuara për zmadhimin e kapitalit. Aksionarët gëzojnë të drejtën e parablerjes në përputhje me aksionet që zotërojnë në shoqëri përpara zmadhimit të kapitalit. Aksionarët kanë të drejtë të heqin dorë nga e drejta për të nënshkruar aksionet e reja.
- 8.3 Kapitali mund të zmadhohet duke emëtuar aksione të reja ose duke rritur vlerën nominale të aksioneve ekzistuese. Aksionet e reja të emëtuara mund të shlyhen në para ose në natyrë.
- 8.4 Në rastet kur zmadhimi i kapitalit kryhet në natyrë, caktohet një ekspert me Vendim Gjykatë për të përcaktuar vlerën e kontributeve në natyrë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 8.5 Zmadhimi i kapitalit duhet të përfundojë brenda 5 vjetëve që nga data që Asambleja e Aksionarëve ka marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit (neni 153 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare).

Neni 9 - Zvogëlimi i Kapitalit

- 9.1 Zvogëlimi i kapitalit realizohet me Vendim të Asamblesë së Aksionarëve për çdo lloj shkak, por, në çdo rast, zvogëlimi i kapitalit, i prek Aksionarët në të njëjtën masë, sipas nenit 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 9.2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të paraqesë Asamblesë së Aksionarëve një raport të bazuar për zvogëlimin e kapitalit, duke specifikuar rrethanat sipas të cilave zvogëlimi i kapitalit është i detyrueshëm.
- 9.3 Vlerësuesi/t për zvogëlimin e kapitalit duhet të njoftohet, të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara ditës që do të merret vendimi nga Asambleja e Aksionarëve për zvogëlimin e kapitalit.

Neni 10 - Shlyerja dhe Verifikimi i kapitalit

- 10.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë duhet të jetë shlyer tërësisht, në rastet kur kapitali zmadhohet duke emëtuar aksione të reja të shlyera në kesh. Në të kundërt, zmadhimi i kapitalit dhe emëtimi i aksioneve të reja konsiderohet i pavlefshëm sipas nenit 154 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

 4

- 10.2 Në rastet e zmadhimit të kapitalit, Këshilli Mbikqyrës duhet të verifikojë depozitimin e kapitalit Aksionar brenda 5 (pesë) vjetësh nga data që rritja e kapitalit është bërë e mundur.

Neni 11 - Aksionet

- 11.1 Aksionet janë nominale. Aksionet jepen me titull transferimi sipas ligjit. Këshilli Mbikqyrës vendos për llojin e titujve të transferimit dhe personat të cilët do të firmosin titujt. Aksionet nominale (të regjistruara) i transferohen palëve të treta në përputhje me nenin 198 të Ligjit të Shoqërive. Në momentin e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj, Shoqëria mund të emetojë aksione të privileguara, të cilat mbizotërojnë mbi aksionet e tjera të emetuara nga shoqëria, sipas neneve 148, 149 të Ligjit Për Shoqëritë tregtare.
- 11.2 Aksionet janë të pandashme. Aksionet kanë një pronar kryesor. Cdo aksion është i barabartë me një votë. Në rastet kur dy ose më shumë pronarë kanë një aksion, vetëm njëri i përfaqëson ata, përndryshe aksioni nuk mund të përfaqësohet dhe e drejta që i korrespondon këtij aksioni do të pezullohet.
- 11.3 Zotëruesi ligjor ushtron të drejtat dhe detyrimet e aksionit.

Neni 12 - Transferimi i Aksioneve

- 12.1 Kur një Aksionar do të transferojë aksionet e tij pjesërisht ose tërësisht, ai është i detyruar të njoftojë me shkrim Këshillin Mbikëqyrës, duke specifikuar cmimin e shitjes së aksionit me qëllim që Aksionarët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Këshilli Mbikëqyrës njofton me shkrim Aksionarët e tjerë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data që është bërë njoftimi për këtë transferim.
- 12.2 Aksionarët e tjerë duhet të njoftojnë me shkrim Këshillin Mbikëqyrës nëse do ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo, brenda tre muajve.
- 12.3 Në rastet kur më shumë se një Aksionar do të blejë aksionet, ata do të blejnë ato në përputhje me aksionet që zotërojnë. Transferimet e aksioneve të bëra ndryshe nga sa parashikohet në këtë nen do të konsiderohen të pavlefshme dhe nuk do të sjellin asnjë pasojë ligjore për Shoqërinë.

Neni 13 – Të Drejtat dhe Detyrimet në Lidhje me Aksionet

- 13.1 Cdo aksion i jep zotëruesit të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shoqërisë në përpjestim me aksionet që ai zotëron, dhe në rastet e likuidimit të drejtën e përfitimit të aseteve të mbetura të Shoqërisë.
- 13.2 Aksionarët janë përgjegjës deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.



- 13.3 Të drejtat dhe detyrimet e aksionit shkojnë bashkë me aksionin pavarësisht transferimit apo formës së transferimit.

KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE

Neni 14 - Asambleja e Aksionarëve

- 14.1 Asambleja e Aksionarëve është organi më i lartë i Shoqërisë. Ajo vendos për cdo çështje dhe vendimet e saj janë të detyrueshme për Aksionaret, Keshillin Mbiqyres dhe Bordin e Drejtoreve.

Neni 15 - Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionarëve

- 15.1 Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionarëve ka të drejtë të marrë cdo vendim përveç atyre të parashikuara në nenin 128 të Ligjit të Shoqërive Tregtare të cilat janë në diskrecionin Asamblesë së Jashtëzakonshme së Aksionarëve.
- 15.2 Vendimet e saj janë të vlefshme në qoftë se në mbledhjen e parë marrin pjesë personalisht ose me prokurë Aksionarë të cilët zotërojnë të paktën $\frac{1}{4}$ e kapitalit Aksionar me të drejtë vote. Në rastet kur mbledhja do të shtyhet në mbledhjen e dytë nuk nevojitet quorumi.
- 15.3 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme së Aksionarëve merren me shumicë të thjeshtë votash (51%) të Aksionarëve të pranishëm.
- 15.4 Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionarëve mbledhet të paktën një herë në vit brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar. Ky afat mund të zgjatet me vendim gjykatë.
- 15.5 Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionarëve analizon dhe vendos për të gjitha çështjet që kanë lidhje me vitin e fundit financiar, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 16 - Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Aksionarëve

- 16.1 Ndryshimet e Statutit të shoqërisë janë e drejtë vetëm e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve.
- 16.2 Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Aksionarëve mund të marrë vendime vetëm në qoftë se në mbledhjen e parë janë të pranishëm personalisht ose me prokurë Aksionaret të cilët përfaqësojnë (zotërojnë) të paktën $\frac{1}{2}$ e kapitalit aksioner me të drejtë vote dhe në mbledhjen e dytë $\frac{1}{4}$ e kapitalit Aksionar. Në qoftë se mbledhja e parë shtyhet atëherë mbledhja e dytë duhet të mbledhet brenda 2 (dy) muajve nga data e mbledhjes së parë.

 6

- 16.3 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve merr vendime me shumicë absolute, d.m.th. $\frac{3}{4}$ e votave të Aksionarëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 17 - Modalitetet e Mbledhjes



- 17.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të thirret nga Këshilli Mbikëqyrës ose Drejtori i Përgjithshëm. Në mungesë të tyre mund të thërritet gjithashtu nga:
- eksperti kontabël,
 - një person i autorizuar nga gjykata në bazë të kërkesës së çdo personi të interesuar (kur është urgjent), të një ose më shumë Aksionarëve të cilët së bashku zotërojnë 1/10 e kapitalit Aksionar.
 - likuidatori
- 17.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve thirret në mënyrën e përcaktuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 17.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve mbahen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër në territorin e Shqipërisë ose në çdo vend tjetër që do të përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 18 - Vlefshmëria e Vendimeve

- 18.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve merr vendime të vlefshme edhe kur nuk janë respektuar procedurat e thirrjes së Asamblesë, në qoftë se të gjithë Aksionarët që janë të pranishëm ose të përfaqësuar, i miratojnë këto vendime. Personi që thërret mbledhjen përgatit rendin e ditës së Asamblesë së Aksionarëve. Njoftimi për shtyrjen e mbledhjes nuk mund ta ndryshojë rendin e ditës.
- 18.2 Një Aksionar mund të përfaqësohet nga një Aksionar i autorizuar, ose bashkëshorti/tja e autorizuar.

Neni 19 - E Drejta e Informimit

- 19.1 Drejtori i Përgjithshëm është i detyruar të vërë në dispozicion të Aksionarëve përpara mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme, dokumentet sic parashikohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 19.2 Çdo Aksionar ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të informohet rreth çështjeve që kanë lidhje me shoqërinë sic parashikohet nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, në selinë e shoqërisë duke filluar çë nga momenti i marrjes së njoftimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Vecanërisht ata kanë të drejtë të informohen për:

- regjistrimin, bilancin, listën e anëtarëve të Drejtorisë dhe listën e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - raportet e Drejtorisë, Këshillit Mbikëqyrës dhe ekspertëve kontabël;
 - shumën e saktë të shpërblimit të personave të sipërpërmendur, etj.
- 19.3 Cdo Aksionar ka të drejtë të marrë informacion ose kopje të listës së Aksionarëve, të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 19.4 Në rastet e refuzimit total ose të pjesshëm të së drejtës për tu informuar të Aksionarëve të shoqërisë atëherë ata mund të drejtohen gjykatës.

Neni 20 – Pjesëmarrës të Tjerë

- 20.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Drejtori dhe ekspertët kontabël mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve duke patur votë konsultative. Në qoftë se ata janë Aksionar vota e tyre është vendimorë.

Neni 21 – Perfaqesimi për aksionet e perbashketa

- 21.1 Në rast se një aksion zotërohet nga më shumë se një person, ata janë të detyruar të caktojnë perfaqesuesin e tyre të perbashkët i cili do të ketë të drejtën e ushtrimit të drejtën e Aksionarit.

Neni 21 – Pjesëmarrës të Tjerë



- 21.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Drejtori dhe ekspertët kontabël mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve duke patur votë konsultative. Në qoftë se ata janë Aksionar vota e tyre është vendimorë.

Neni 21 - Librat

- 21.1 Emri i cdo pjesëmarrësi në Asamblesë e Përgjithshme regjistrohet në një libër të vecantë.
- 21.2 Mbledhjet regjistrohen në procesverbale.

Neni 24 – Kryesia

- 24.1 Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ose në mungesë të tij zëvendësi I tij ose perfaqesuesi I caktuar nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të pranishëm drejton Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve.

Neni 25 – Te drejtat e Pakices se Aksionareve

- 25.1 Aksionaret qe kane 1/20 e kapitalit te shoqerise mund te mbledhin Mbledhjen e Jashtezakonshme te Aksionareve duke percaktuar dhe rendin e dites. Keshilli Mbikeqyres eshte i detyruar te mbledhe mbledhjen e Jashtezakonshme kur kerkohet, pervec rasti kur ka arsye te forte. Aksionaret qe kane 1/20 e kapitalit te shoqerise mund te pretendojne ne gjykate ekzistencen e arsyes se forte dhe te therrasin Mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme.
- 25.2 Aksionaret qe kane 1/10 e kapitalit te shoqerise mund ti kerkojne vetem nje here Kryetarit te Asamblese te pezulloje miratimin e vendimit te Mbledhjes se Zakonshme ose te Jashtezakonshme, duke vendosur ditën e takimit te ardhshem, i cili nuk duhet te tejkaloje 30 (tridhjetë dite) qe nga data e pezullimit te takimit te pare.

Neni 26 - Këshilli Mbikqyrës

- 26.1 Këshilli Mbikqyrës është autoriteti që mbikeqyr administrimin e Shoqërisë. Përbërja e tij është 3 (tre) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Këshilli i parë Mbikqyrës i shoqërisë përbëhet nga anëtarët e mëposhtem:

- 1- Z. Apostolos Touralias –Kryetar
- 2- Z. Panagiotis Kolios (anetar)
3. Z. Aleks Naco (anetar)

- 26.2 Anetarët e Keshillit Mbikeqyres te zgjedhur nga Mbledhja e Pergjithshme nuk mund te jene punemarres te shoqerise.
- 26.3 Kryetar i Keshillit të parë Mbikqyrës është Z. Apostolos Touralias.

Neni 27 - Anëtarësia


- 27.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë detyrimisht aksionare. Anetari i Keshillit Mbikeqyres eshte personalisht pergjegjes ndaj palëve të treta dhe Aksionareve te Shoqerise. Këshilli Mbikqyrës është përgjegjës kundrejt shoqërisë për detyrat që kryen.
- 27.2 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës qëndrojnë në detyrë për 2 (dy) vjet, periudhë e cila mund të zgjatet edhe për një afat tjetër 2 (dy) vjekar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve te mbledhur per te miratuar pasqyrat financiare te vitit te fundit financiar.
- 27.3 Këshilli Mbikëqyrës cakton një Kryetar dhe një zëvendës të tij. Kryetari drejton mbledhjen dhe në mungesë të tij atë e zëvendëson zëvendës kryetari.



- 27.4 Në rast vdekjeje, largimi ose të tre mungesave pa arsye radhazi në tre mbledhje të një anëtari, Këshilli Mbikqyrës cakton një zëvendës deri në mbledhjen e radhës të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Neni 28 - Mbledhjet

- 28.1 Këshilli Mbikqyrës është organ kolegjal, përgjegjës dhe mbikëqyrës për shoqërinë. Ai bën shqyrtim dhe merr vendime vetëm nëpërmjet mbledhjeve të tij. Këshilli mbikëqyrës mbledhet rregullisht një herë në tre muaj dhe sa herë që e kërkon interesi i Shoqërisë.
- 28.2 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren nga Kryetari dhe në mungesë të tij nga anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës.
- 28.3 Këshilli Mbikqyrës merr vendime me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit është përcaktuese.
- 28.4 Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës mbahet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër të treguar në thirrje. Thirrja për mbledhje duhet t'u dërgohet anëtarëve të Këshillit tre ditë përpara me letër, telegram, ose cdo formë zyrtare komunikimi.
- 28.5 Këshilli Mbikqyrës ka një quorum dhe konsiderohet ligjërish i mbledhur kur janë prezent ose të përfaqësuar me shumë se 50% e anëtarëve. Anëtarët që mungojnë mund të përfaqësohen vetëm nga një anëtar tjetër i Këshillit Mbikqyrës.
- 28.6 Këshilli Mbikqyrës ka tagra të vendosë për cdo çështje që ka të bëjë me administrimin e shoqërisë, administrimin e pronës dhe arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës nuk mund të vendosë për çështje të cilat janë e drejtë e Asamblesë së Aksionarëve.
- 28.7 Cdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, mund t'i japë mandat një anëtar tjetër për ta përfaqësuar në mbledhjen e Këshillit. Cdo anëtar mund të japë vetëm një mandat për të njëjtën mbledhje. Anëtarit i përfaqësuar nuk merret parasysh në llogaritjen e quorumit të anëtarëve të pranishëm.
- 28.8 Diskutimet dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës shënohen në procesverbal se bashku me mendimet e kundërta, i cili duhet të nënshkruhet nga kryetari i seancës dhe të paktën nga një anëtar i Këshillit.
- 28.9 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfitojnë shpërblim, masa e të cilit caktohet nga Asambleja e Aksionarëve.



Neni 29 – Vendimet

- 29.1 Diskutimet dhe vendimet e Keshillit Mbikëqyrës regjistrohen në proccverbal dhe vendime të Keshillit Mbikëqyrës cilet duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët së bashku me mendimet e kundërta të anëtarëve të cilet nuk janë dakord.
- 29.2 Këshilli Mbikëqyrës ka tagra të vendosë për çdo çështje që ka të bëjë me administrimin e shoqërisë, administrimin e pronës dhe arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të vendosë për çështje të cilat janë e drejtë e Asamblesë së Aksionarëve.
- 29.3 Cdo anëtar i Keshillit Mbikëqyrës, mund t'i japë mandat një anëtarit tjetër për ta përfaqësuar në mbledhjen e Keshillit. Cdo anëtar mund të japë vetëm një mandat për të njëjtën mbledhje. Anëtarit i përfaqësuar nuk merret parasysh në llogaritjen e quorumit të anëtarëve të pranishëm.

Neni 30 – Bordi i Drejtoreve

- 30.1 Anëtarët e Bordit të Drejtoreve emrohen nga Keshilli Mbikëqyrës.
- 30.2 Anëtarët e Bordit të Drejtoreve domosdoshmërisht nuk duhet të jenë domosdoshmërisht anëtarë të Keshillit Mbikëqyrës. Anëtarët e Bordit të Drejtoreve duhet të jenë persona fizike.
- 30.3 Bordi i Drejtoreve përbëhet nga tre anëtarë: : Mr. Panagiotis Boutopoulos, b) Mr. Achilea Papuci and c) Mr. Konstantinos Glavas (anëtar jo-executive).
- 30.4 Një prej anëtarëve të Bordit të Drejtoreve është i emëruar nga Keshilli Mbikëqyrës në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm.
- 30.5 Drejtori i parë i përgjithshëm është Z. Panagiotis Boutopoulos.

Neni 31- Koberzgjatja

- 31.1 Anëtarët e Bordit të Drejtoreve kanë një mandat 2 (dy) vjeçar.
- 31.2 Në rast të një vendi vakant, zëvendësimi duhet të bëhet brenda një periudhe 2 mujore. Në rast të zëvendësimit të një anëtarit, anëtarit i ri duhet të mbajë mandatin deri në emërimin e Bordit të ri të Drejtoreve.
- 31.3 Keshilli Mbikëqyrës mund të shkarkojë në çdo kohë për shkak të arsyeshme anëtarët e Bordit të Drejtoreve.



Neni 32- Funksionimi


- 32.1 Anetaret e Bordit te Drejtoreve mund te ndajne detyrat me miratimin paraprak te Keshillit Mbikeqyres. Bordi duhet te informohet periodikisht mbi vendimet e anetareve te tij.
- 32.2 Bordi i Drejtoreve perfaqesohet ne marredhenie me te tretet nga Drejtori i Pergjithshem.

Neni 33- Mbledhjet

- 33.1 Bordi i Drejtoreve mblidhet sa here qe kerkon interesi i shoqerise. Mbledhjet e Bordit te Drejtoreve jane te organizuara nga Drejtori i Pergjithshem. Njoftimi per mbledhje u dergohet anetareve ne forme te shkruar me poste, poste rekomande, fax, telex, poste elektronike ose cdo menyre tjeter te pkten tre dite perpara mbledhjes.
- 33.2 Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise ose cdo vend tjeter ne Shqiperi ose jashte shtetit, nese anetaret e Bordit jane te pranishem dhe dakord. Mbledhjet drejtohen nga Drejtori i Pergjithshem.
- 33.3 Vendimet merren me shumice te thjeshte votash. Votimi nepermjet perfaqesimit eshte i lejuar.

Neni 34- Kompetencat.

- 34.1 Bordi i Drejtoreve gezon komptence te plote te veproje ne cdo rrethane ne emer dhe per llogari te shoqerise, me kusht qe keto kompetenca nuk jane ne diskrecionin e Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionareve ose Keshillit Mbikeqyres.
- 34.2 Bordi i Drejtoreve ushtron kompetencat e tij brenda kufijve te objektit te shoqerise.
- 34.3 Ne rast se nje transaksion kerkon autorizimin e Keshillit Mbikeqyres dhe ky i fundit e refuzon ate, Bordi i Drejtoreve mund te mbledhe Mbledhjen e Aksionareve dhe ti parashtroje ceshtjen.
- 34.4 Bordi i Drejtoreve pergatit raportet dhe rendin e dites te mbledhjeve te Keshillit Mbikeqyres dhe Mbledhjen e Aksionareve
- 34.5 Brenda 3 muajve qe nga mbyllja e vitit financiar, Bordi i Drejtoreve pergatit dhe parashtron llogarite vjetore dhe raportin vjetor te aktivitetit financiar per tu certifikuar dhe kontrolluar nga Keshilli Mbikeqyres.



- 34.6 Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson shoqërinë me firmën e tij të vetme për të gjithë transaksionet që kanë vlerë jo më shumë se 100,000 Euro. Bordi i Drejtorëve do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për çdo transaksion mbi vlerën 100,000 Euro.

KAPITULLI IV

KONTROLLI I I SHOQËRISË

Neni 35 - Eksperti Kontabël


- 35.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve cakton ekspertët kontabël të cilët kanë të drejtë të:
- Kontrollon mbajtjen e llogarive në përputhje me parimet kryesore të kontabilitetit.
 - përgatit raportin vjetor me të dhënat ekonomike (bilancin, llogaritjen e fitimeve dhe humbjeve dhe dokumente të tjera që kanë lidhje me to) dhe japin mendimin e tyre nëse të dhënat ekonomike pasqyrojnë gjëndjen aktuale financiare të shoqërisë;
 - informojnë Këshillin Mbikëqyrës rreth çdo parregullsie të mundshme të vëne re në procedurë, aktivitet dhe llogaritë e shoqërisë që mund të kenë shkaktuar humbje shoqërisë, etj.

Neni 36 - Kompetencat

- 36.1 Eksperti kontabël ka mandat 1 (një) vjeçar financiar.
- 36.2 Eksperti kontabël është i detyruar të mbikëqyrë llogaritë vjetore të cilat janë hartuar në bazë të Ligjit për Kontabilitetin dhe përmbajnë rezultatet e periudhës ushtrimore dhe vitit të mbyllur financiar. Eksperti kontabël ka kompetencat që janë parashikuar në ligjin Për Shoqëritë Tregtare dhe aktet e tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore.
- 36.3 Në qoftë se eksperti kontabël nuk përmbush me përpikëri detyrat e tij atëherë ai mund të shkarkohet me vendim gjykatë .
- 36.4 Eksperti i parë kontabël i shoqërisë është Znj. Elza Balla.

Neni 37- Librat e shoqërisë

- 37.1 Shoqëria duhet të mbajë librat e kërkuar nga ligji në të cilët regjistrohen: llogaritë vjetore, gjendja financiare vjetore, bilanci vjetor dhe raporti ekonomik vjetor.



- 37.2 Librat zyrtarë të shoqërisë dhe gjendja financiare vjetore, bilanci vjetor dhe raporti financiar vjetor mund të mbahen për gjuhën Shqipe dhe mund të mbahen edhe në gjuhë të tjera.

Neni 38 - Viti financiar

- 38.1 Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga 1 Janari dhe mbaron më 31 Dhjetor me përjashtim të vitit të parë financiar i cili fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor 2007.
- 38.2 Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr llogaritë vjetore dhe kërkon që ato të jenë hartuar në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe përpilon raportin mbi administrimin.

Neni 39- Fondi rezerve

- 39.1 Fondi i nevojshem rezerve krijohet nga te pakten 5% e fitimit neto pasi të jenë hequr humbjet e vitit parardhës. Kjo procedure nuk është e detyrueshme në rast se fondit rezerve është sa 1/10 e kapitalit aksionar.

Neni 40 – Ndarja e fitimeve

- 40.1 Fitimi llogaritet si rezultat i fitimeve të pasqyruara në bilanc duke zbritur rezervat dhe humbjet e viteve financiare të kaluara.

Neni 42 - Dividendët

- 32.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe pasi është vendosur shuma që do të ndahet, Asambleja e Aksionarëve përcakton shumën që do të shpërndahet Aksionarëve si dividend sipas neneve 215, 216 të Ligjit të Shoqërive tregtare.

KAPITULLI V

PRISHJA - LIKUIDIMI

Neni 42 - Prishja

- 42.1 Shoqëria priset kur mbaron afati i përcaktuar në Statut, nëse ka, kur falimenton ose kur e vendos Asambleja e Përgjithshme.

Neni 43 - Likuidimi

- 43.1 Shoqëria likuidohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.



- 43.2 Shoqëria likuidohet në rastin e prishjes së saj për çfarëdolloj arsyeje, përveç atyre të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

KAPITULLI VI

Neni 44 - Dispozita të Përgjithshme

- 44.1 Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të interpretohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 44.2 Ky Statut u hartua në 5 (pese) kopje në gjuhën Shqipe dhe Angleze dhe pasi iu lexua Aksionarëve ne prani te perkthyeses se gjuhes angleze Sofika Rapi u nënshkrua rregullisht prej tyre.
- 44.3 Shoqëria do të fillojë aktivitetin pas miratimit të organeve kompetente shqiptare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

AKSIONARËT E SHOQËRISË ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE

SH.A

1. Në emër dhe për llogari të "Andromeda S.A."

Z. Panagiotis Boutopoulos

Panagiotis Boutopoulos

2. Z. Ahilea Papuci

Ahilea Papuci